



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1624/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Elektring” SH.P.K. me seli në Çagllavicë, Prishtinë, të cilin e përfaqëson Naim Ferati avokat në Ferizaj, kundër debitorit “Gama Ing” SH.P.K., me seli në rr.“Brigada 153” p.nr., në Hajvali, Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.917/2022 të datës 29.09.2023, me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit Elektring SH.P.K. me seli në Çagllavicë, Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.917/2022 i datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.917/2022 të datës 29.09.2023, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Gama Ing” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka anuluar urdhrin P.nr.396/2021 të datës 18.06.2021 të përmbartuesit privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj, dhe ka përfunduar në tërësi procedurën përmbartimore në këtë çështje.

Kundër aktvendimit të lartcekur brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuarit i kreditorit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar ashtu që të aprovohet urdhri përmbartimor, apo aktvendimi i ankimuar të prishet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, duke e kundërshtuar ankesën e autorizuarit të kreditorit, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pathemeltë dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Elektring” SH.P.K. me seli në Çagllavicë, Prishtinë, të cilin e përfaqëson Naim Ferati avokat në Ferizaj, me datë 18.06.2021, ka paraqitur propozim për përmbaerim kundër debitorit “Gama Ing” SH.P.K., me seli në rr.“Brigada 153” p.nr., në Hajvali, Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.1278/2020 të datës 18.11.2020, në shumë prej 43.00 Euro dhe faturës nr.1339/2020 të datës 01.12.2020, në shumë prej 386.60 Euro.

Përmbaeruesi privat Besnik H. Aliu, duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit me urdhrin P.nr.396/2021 të datës 18.06.2021, ka lejuar përmbaerimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbaerim.

Kundër këtij urdhri përmbaerimor debitori me datë 29.06.2021 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaerimor, me arsyetimin se kreditori e kërkon borxhin pa ndonjë bazë, për arsye se i njëjti nuk i ka dërguar mallin debitorit. Tutje ka deklaruar se faturat nuk përmbajnë nënshkrimin dhe vulën e debitorit, për tu vërtetuar si fatura të rregullta. Andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhri i përmbaeruesit privat.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 02.07.2021, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se pretendimet e debitorit janë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, se faturat lëndore janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, pasi që malli të njëjtit i është dorëzuar dhe bashkë me të edhe fletëdërgesa të cilën e ka nënshkruar. Tutje ka theksuar se është i pabazë pretendimi i debitorit se që nga vitit 2019 nuk kanë raport afarist, pasi që gjatë vitit 2020 ka pasur shitblerje mes tyre. Andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi si i pabazuar dhe të lihet në fuqi urdhri për lejimin e përmbaerimit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.917/2022 të datës 29.09.2023, ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Gama Ing” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka anuluar urdhrin P.nr.396/2021 të datës 18.06.2021 të përmbaeruesit privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj dhe ka përfunduar në tërësi procedurën përmbaerimore në këtë çështje.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbaerimor duhet të anulohet dhe procedura përmbaerimore të përfundohet në tërësi, për shkak se dokumenti i besueshëm – fatura nr.1339/2020 e datës 1.12.2020 mbi bazën e së cilës mbështetet propozimi për përmbaerim, e mbi bazën e së cilës përmbaeruesi ka lejuar përmbaerimin, nuk ka tipare të përmbaerueshmërisë, për arsye se fatura nr.1339/2020 e datës 01.12.2020 në vlerë prej 386.60 Euro nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se ajo nuk është pranuar nga

debitori, gjegjësisht ajo nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit e as vulën e debitorit, si dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga debitori. Prandaj kjo faturë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale, në këtë rast debitori, nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura. Tutje gjykata ka arsyetuar se kërkesa që rrjedhë nga fatura nr.1278/2020 e datës 18.11.2020 në vlerë prej 48 Euro është përmbushur nga debitori me datë 27.11.2020, siç rrjedhë nga kartela e klientit në emër të debitorit e lëshuar nga kreditori dhe nga dëftesë pagesa, e cila gjendjet në shkresat e lëndës. Meqenëse fatura është paguar, gjykata ka gjetur se e njëjta e ka humbur efekt, rrjedhimisht nuk mund të kërkohej përmbartimi në bazë të saj.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura nr.1339/2020 e datës 01.12.2020, në shumë prej 386.60 Euro, e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban nënshkrim nga debitori. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, i cili përcakton se: *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës*, kurse me paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore, kjo gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura nr.1339/2020 e datës 01.12.2020, në shumë prej 386.60 Euro si dokument i besueshëm mbi të cilën është iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura nuk e përmban nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Që nënkupton se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Sipas gjykatës ankimore, dhoma e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka vlerësuar se për faturën nr.1278/2020 të datës 18.11.2020, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nuk mund të kërkohet përmbarimi, pasi që detyrimi i kësaj fature në shumë prej 43.00 Euro, është përmbushur nga ana e palës debitore dhe kjo vërtetohet nga pagesa – dëftesa e datës 27.11.2020 ku shihet se debitori ka paguar faturën nr.1278/2020, andaj pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit lidhur me atë së detyrimi për këtë faturë nuk është përmbushur nga debitori janë të paqëndrueshme, pasi që dëftesa lartcekur në mënyrë të pakontestueshme e dëshmon përmbushjen e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit lidhur me faturën kontestuese.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1624/2023 me datë 19.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha